



ADMINISTRATA DOGANORE SHQIPTARE

Newsletter | Gusht 2025

➡ MINISTRI I FINANCAVE DHE DREJTORI I PËRGJITHSHËM I DOGANAVE INSPEKTOJNË SKANERIN E PORTIT TË DURRËSIT

Ministri i Financave, Petrit Malaj, së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave, Genti Gazheli, zhvilluan një vizitë pranë skanerit të Portit të Durrësit, ku gjatë muajve të fundit është shënuar një ulje e ndjeshme e numrit të skanimeve. Ky zhvillim ka sjellë lehtësim të dukshëm të procesit për operatorët ekonomikë dhe është mirëpritur nga shoqëritë e transportit, të cilat kanë vlerësuar reduktimin e kohës së pritjes dhe trajtimin më efikas të fluksit.

Ky përmirësim është rezultat i marrëveshjes së firmosur në muajin prill, në prani të Kryeministrit Edi Rama, e cila garanton një qasje të koordinuar mes Doganës dhe Policisë së Shtetit, me kontrole të targetuara vetëm mbi bazën e riskut. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, po punohet për të reduktuar edhe më tej numrin e skanimeve, duke siguruar balancën e duhur mes sigurisë dhe lehtësive për biznesin.



➡ DY LIGJE TË REJA PËR MARKAT TREGTARE DHE PATENTAT

Prej datës 16 gusht kanë hyrë në fuqi dy ligje të rëndësishme që rregullojnë fushën e pronësisë industriale në Shqipëri:

- Ligji *“Për markat tregtare”*
- Ligji *“Për patentat, modelet e përdorimit dhe certifikatat e mbrojtjes shtesë”*



Këto ligje përmbushin një objektiv madhor të qeverisë shqiptare për përafrimin e plotë të kuadrit ligjor me standardet e Bashkimit Evropian, duke ofruar mbrojtje më të gjerë dhe më të fortë për shpikësit, bizneset, qytetarët dhe profesionistët e fushës.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka një rol thelbësor në mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, duke qenë në vijën e parë të kontrollit të qarkullimit ndërkufitar të mallrave. Nëpërmjet zbatimit të dy ligjeve të reja dhe rolit aktiv të Doganës Shqiptare, garantohej një treg më i ndershëm, më i sigurt dhe në përputhje me standardet evropiane, duke mbrojtur interesat e sipërmarrjes, qytetarëve dhe konsumatorëve.

➡ DOGANA SHQIPTARE, VLERËSIM POZITIV NGA INDEKSI I BIZNESIT I DHOMËS AMERIKANE TË TREGTISË

Administrata Doganore është renditur ndër institucionet me vlerësimin pozitiv nga Indeksi i Biznesit 2025, i publikuar së fundmi nga Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri (AmCham). Ky indeks mat perceptimin e komunitetit të biznesit mbi klimën ekonomike në vend dhe efektivitetin e institucioneve publike në mbështetje të sipërmarrjes.

Në këtë vlerësim, Dogana Shqiptare evidentohet për përmirësimet në transparencë, profesionalizëm dhe përpjekjet për të lehtësuar proceset për biznesin, veçanërisht në raport me thjeshtimin e procedurave, digjitalizimin e shërbimeve dhe rritjen e bashkëpunimit me sektorin privat.

Ky rezultat pasqyron qartësisht orientimin e administratës doganore drejt një modeli modern dhe efikas, që vendos në qendër shërbimin ndaj qytetarëve dhe bizneseve.



➡ DOGANAT, STRATEGJI TË RE PËR SISTEMET DIGJITALE DOGANORE SIPAS STANDARTEVE TË BE-së

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me AKSHI-n dhe UNCTAD dhe me asistencën e DG Taxud ka filluar prej kohësh draftimin e Strategjisë për Zhvillimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në kuadër të aderimit në Bashkimin Evropian.

Grupi i Përhershëm i Punës zhvilloi mbledhjen e radhës duke u fokusuar në tre kolonat kryesore të sistemeve:

I. Sistemet qendrore Transevropiane të zhvilluara nga Komisioni që mund të kërkojnë dhe zhvillime nga vendet candidate, ku përfshihen 18 sisteme IT si: për shkëmbimin e certifikatave të Dritares së Vetme Doganore të BE-së; kontrolli importit; menaxhimi i riskut doganor; eksportuesit të regjistruar; informacioni i detyrueshëm tarifor evropian; regjistrimi dhe identifikimi i operatorit ekonomik- EORI2; AEO; menaxhimi i garancisë; sistemi IPR; tarifa e integruar etj.

II. Sistemet e decentralizuara Transevropiane të zhvilluara nga Komisioni dhe që kanë një komponent kombëtar që do të zhvillohet nga vendet candidate për në BE, si NCTS (sistemi tranzitit), Sistemi Autorizuar i Eksportit dhe sistemi i zhdoganimit të centralizuar për import;

III. Kërkesat e BE-së për sistemet kombëtare që duhet të zhvillohen ekskluzivisht nga vendet candidate që synojnë zbatimin e proceseve të përcaktuara në legjislacionin e UCC dhe Dritares së vetme (SW) të BE-së, ku përfshihen Njoftimi i mbërritjes, prezantimit dhe magazinimit të përkohshëm dhe Sistemi kombëtar i importit.



➡ DOGANA SHQIPTARE NË FAQET E REVISTËS NDËRKOMBËTARE RILO ECE HERALD

Zyra Ndërlidhëse Rajonale e Inteligjencës për Evropën Qendrore dhe Lindore (RILO ECE), në numrin e saj të radhës Herald 2/2025, ka pasqyruar punën e Doganës Shqiptare me dy artikuj të veçantë, të botuar në faqet 24–26 të revistës. Artikulli i parë, “Seizure of IPR goods” sjell në vëmendje rastin e sekuestrimit nga Dogana Shqiptare të një sasie të konsiderueshme mallrash të dyshuara për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale. Artikulli tjetër, “Western Balkans and EU customs leaders reaffirm commitment to deeper integration and seamless trade”, thekson rolin e Doganës Shqiptare si institucion pritës i Konferencës së Nivelit të Lartë të Drejtorëve të Përgjithshëm të Doganave të Ballkanit Perëndimor dhe vendeve të BE-së, e mbajtur në Tiranë më 12 qershor 2025. Ky publikim ndërkombëtar, i realizuar nën kujdesin e Organizatës Botërore të Doganave, është një tjetër dëshmi e rolit aktiv të Doganës Shqiptare në forcimin e sigurisë, integrimin rajonal dhe modernizimin e shërbimeve doganore.

